Raporti individual i konsultimit publik

1. Titulli i projekt aktit

Projektvendim "Për përcaktimin e dokumentacionit, afateve dhe procedurës së konkurrimit për dhënien me qera të zonës së gjuetisë, mbarështimit dhe ripopullimit."

Ky projektvendim ka për qëllim krijimin e një kuadri të plotë dhe të qartë rregullator për përcaktimin e dokumentacionit, afateve dhe procedurave që ndiqen në procesin e konkurrimit publik për dhënien me qira të zonave të gjuetisë, mbarështimit dhe ripopullimit të faunës së egër. Nëpërmjet këtij akti synohet të standardizohet dhe të unifikohet praktika administrative në nivel vendor, duke siguruar që procesi i përzgjedhjes së subjekteve për menaxhimin e këtyre zonave të zhvillohet në mënyrë transparente, të drejtë dhe konkurruese.

Objektivat kryesore që synohen të arrihen nëpërmjet këtij projektvendimi janë:

- krijimi i një procedure të standardizuar dhe të kontrolluar për dhënien me qira të zonave të gjuetisë, mbarështimit dhe ripopullimit;
- garantimi i transparencës dhe barazisë së trajtimit për të gjithë subjektet pjesëmarrëse në konkurrim;
- përzgjedhja e subjekteve me kapacitetet e duhura teknike, profesionale dhe financiare për menaxhimin efektiv të zonave;
- sigurimi i menaxhimit të qëndrueshëm të faunës së egër, duke respektuar balancat ekologjike dhe kuotat e lejuara të gjuetisë;
- mbrojtja e biodiversitetit dhe e habitateve natyrore nga dëmtimet dhe shfrytëzimi i pakontrolluar;
- forcimi i mekanizmave për parandalimin e gjuetisë së paligjshme dhe aktiviteteve të tjera që cënojnë mjedisin;
- rritja e përgjegjshmërisë së subjekteve që administrojnë zonat e gjuetisë;
- nxitja e zhvillimit ekonomik lokal përmes përdorimit të qëndrueshëm të këtyre zonave dhe krijimit të mundësive për investime dhe punësim.

Në tërësi, projektvendimi synon të vendosë një balancë të qëndrueshme ndërmjet shfrytëzimit ekonomik të zonave të gjuetisë dhe nevojës për mbrojtjen e mjedisit, duke kontribuar në ruajtjen afatgjatë të pasurive natyrore dhe zhvillimin e qëndrueshëm të territorit.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse

kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Kohëzgjatja e konsultimit publik për këtë akt ishte 20 ditë pune nga data e shpalljes së njoftimit në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, bazuar në ligjin 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik.

Publikimi u bë në datë 8.5.2026 dhe nëpërmjet një njoftimi të publikuar online në RENJK, të gjitha palët e interesuara: 1) organet publike; 2) shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe grupet e interesit; ishin të ftuar për të paraqitur komentet dhe rekomandimet e tyre për projektaktin, në adresën e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik në Ministrinë e Mjedisit.

Data e mbylljes së procesit të konsultimit publik ishte 5.6.2026.

Projektakti "Për përcaktimin e dokumentacionit, afateve dhe procedurës së konkurrimit për dhënien me qera të zonës së gjuetisë, mbarështimit dhe ripopullimit", relacioni përkatës si dhe njoftimi për konsultim publik u publikuan në linkun, www.konsultimipublik.gov.al.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese…, dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Projektvendimi, në zbatim të ligjit 146/2014, i është nënshtruar procesit të konsultimit publik, në portalin "Regjistri elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike", nga data 8.5.2026 deri në datën 5.6.2026. Përgjatë kësaj periudhe ka patur 345 shikime në RENJKP, por nuk janë regjsitruar komente në RENJKP dhe as nëpërmjet postës elektronike.

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.
Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Projektakti është hartuar nga Ministria e Mjedisit, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse në fushën e mjedisit.
Nuk ka patur palë të interesua gjatë procesit të konsultimit publik.

5. **Pasqyra e komenteve të pranuara me arsyetimin e komenteve të pranuara/ refuzuara**

Gruponi komentet/ propozimet e pranuara sipas çështjes që ato ngritën;
Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;
Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Nuk ka patur komente.

Çështja e adresuar	**Komenti**	**Palët e interesuara**	**Vendimi**	**Justifikimi**